

PROCESVERBAL
nga seanca e 10-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 10.3.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, Goran Radunoviq, dr. Ivana Stojanovska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, mr. Goran Sheqerinov, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 10-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 12:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 4-ët publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 2.3.2026.
2. Miratimi i Propozim-Procesverbalit të seancës së 9-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 2.3.2026.
3. Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes të ShTR Televizija Koçani-LD ShPKNJP Koçan.
4. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetimit televiziv të ShTR TV Gurra ShPKNJP Kërçovë.
5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: Hulumtim mbi arsimimin mediatik tek nxënësit e shkollës së mesme të vitit të tretë dhe të katërt.
6. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe me 6 vota "pro" dhe një votë "abstenim" nga Petar Xhurovski, miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 4-ët publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 2.3.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli shqyrtoi dhe me 6 vota "pro" dhe një votë "abstenim" nga Petar Xhurovski, miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 9-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 2.3.2026, me tekstin e propozuar.

Pika a 3

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, shpjegoi Propozimin për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes të ShTR Televizija Koçani-LD ShPKNJ P Koçan. Në shpjegim, ai theksoi se transmetuesit, më 12 janar të këtij viti, i është dorëzuar faturë për pagesë të kompensimit vjetor për transmetim televiziv në shumë prej 127.146,00 denarësh, e cila nuk është paguar në afatin e përcaktuar ligjor prej 30 ditësh. Për shkak të mosveprimit sipas detyrimit, Këshilli në seancën e mbajtur më 24 shkurt, ka inicuar procedurë për heqjen e lejes. Ndërkohë, më 5 mars, plotësisht e ka paguar shumën bazuar në kompensimin vjetor, me ç'rast janë përmbushur kushtet ligjore që drejtuar Këshillit të paraqitet propozim për ndalimin e procedurës për heqjen e lejes.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizija Koçani-LD ShPKNJ P Koçan, PA1 nr.08-44 të datës 7.9.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-697/3 të datës 6.3.2026, ShTR Televizija Koçani-LD ShPKNJ P Koçan, kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv e ka paguar plotësisht, sipas faturës së paraqitur me nr.2026-100-0014 datë 12.1.2026.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, detyrohet që aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 4

Drejtori Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV Gurra ShPKNJ P Kërçovë. Ai citoi se transmetuesi nuk e kishte paguar kompensimin vjetor për transmetim televiziv në shumën prej 118.740,00 denarë, dhe se Agjencia dhe më parë kishte pasur probleme në përmbushjen e detyrimeve ligjore. Pas dy përpjekjeve të pasuksesshme për të dorëzuar faturën, ajo iu dërgua në adresë elektronike me e-mail me të cilën transmetuesi është i regjistruar në Regjistrin Qendror. Afati ligjor prej 30 ditësh nga pranimi i faturës skadoi më 7 mars dhe pagesa nuk u krye. Prandaj, propozohet që Këshilli të miratojë vendim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga pyeti se në cilën mënyrë u realizua komunikimi me TV Gurra, përkatësisht nëse transmetuesi është kontaktuar me telefon ose me e-mail.

Udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë, Goran Radinoviç , shpjegoi se, në pajtim me ligjin, fatura ishte dërguar dy herë me postë të rekomanduar, por nga shërbimi postar ishte dhënë njoftim se dërgesa nuk ishte tërhequr. Pas përmbushjes së kushtit për dërgesë të dyfishtë me postë, fatura ishte dërguar në e-mail zyrtar tek transmetuesi, pas së cilës ai ishte njoftuar edhe me telefon. Ai shtoi se para disa ditëve përsëri është realizuar kontakt me telefon, gjatë të cilit transmetuesi ishte informuar se afati i fundit për pagesë ishte 7 marsi 2026, por menjëherë deklaroi se për momentin nuk do ta kryente pagesën dhe se ishte e mundur pagesën ta kryente në afatin shtesë prej 15 ditësh.

Këshilltari Jajaga, pas shpjegimit të dhënë, konstatoi se transmetuesi disa herë ishte kontaktuar dhe informuar.

Këshilltari Petar Xhurovski pyeti se cila është procedura për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, përkatësisht nëse dërgohet paraprakisht paralajmërim dhe cili është afati i pagesës.

Drejtori Trajçevski shpjegoi se, në lidhje me pagesën e taksës për transmetim televiziv ose radio, ligji nuk parashikon dërgimin e një paralajmërimi, por përcakton afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të faturës për kryerjen e pagesës. Nëse tarifa nuk paguhet brenda këtij afati, iniciohet një procedurë për heqjen e lejes, me një afat shtesë prej 15 ditësh. Nëse brenda këtij afati pagesa nuk kryhet, atëherë leja hiqet.

Këshilli i Agjencisë njëzëri incoi procedurën për heqjen e lejes për transmetimi televiziv të ShTR TV Gurra ShPKNjP Kërçovë, PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023, për shkak të mospërmbushjes së detyrimit sipas nenit 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht për mospagesë të kompensimit vjetor të lejes për transmetim televiziv ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr.2026-100-0020 datë 1/12/2026.

Nëse transmetuesi në fjalë nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për Iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV Gurra ShPKNjP Kërçovë, PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023, për shkelje të nenit 80, paragrafi (5) të LShMAAV.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit – hulumtimi mbi arsimimin mediatik tek nxënësit e shkollave të mesme të vitit të tretë dhe të katërt. Në shpjegim citoi se Agjencia ka detyrim ligjor për nxitje të arsimimit mediatik, dhe në kuadër të saj, të bashkëpunojë me institucionet kompetente, në rastin konkret me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Furnizimi është parashikuar në Planin vjetor për furnizim publik të Agjencisë për vitin 2026, dhe fondet për realizimin e tij sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë. Në pajtim me vlerën e parashikuar, procedurë do të kryhet si procedurë e hapur e thjeshtuar, sipas së cilës do të respektohen dispozitat e Ligjit për furnizim publik. Procedura do të filloni me publikim të njoftimit në Sistemin Elektronik për furnizime publike dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Të gjitha të dhënat e tjera në lidhje me furnizimin publik përmbahen në materialet e paraqitura për këtë pikë.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli pyeti se cilat shkolla të mesme do të përfshihen në hulumtimin e arsimit mediatic.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, shpjegoi se mostra për këtë anketë, si dhe mostra për anketën e kryer në vitin 2023 me nxënës të vitit të parë dhe të dytë, do të përpilohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Hulumtimi me shumë mundësi do të përfshijë nxënës nga të gjitha shkollat e mesme në vend, nga shkolla e mesme (gjimnaze) dhe arsimit profesional. Pas përzgjedhjes së operatorit ekonomik, Ministria do të sigurojë të dhënat e nevojshme, pas së cilës operatori i përzgjedhur do ta kryejë hulumtimin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: hulumtim mbi arsimimin mediatic tek nxënësit e shkollave të mesme të vitit të tretë dhe të katërt.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën - hulumtim mbi arsimimin mediatic tek nxënësit e shkollave të mesme të vitit të tretë dhe të katërt është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nr.05-869/1 datë 4.3.2026 (tekst i pastruar), ndërsa fondet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Pika 6

Të ndryshme

Këshilltarja Cvetanka Minovska informoi se tashmë është formuar grup pune për ndryshimet në Kodin Zgjedhor dhe se është zgjedhur kryetari i grupit. Ajo e pyeti drejtorin nëse Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ka marrë ftesë për pjesëmarrje në grupin e punës për pjesët që kanë të bëjnë me Agjencinë, me qëllim që të shmangen problemet për zgjedhjet e ardhshme parlamentare ose lokale, veçanërisht në lidhje me dispozitat e ligjit që kanë të bëjnë me reklamimin e paguar politik. Plotësuese, propozoi që Agjencia të ndërmarrë iniciativë për rregullimin e reklamimit të paguar politik në portalet online, me kusht që portalet që nuk janë të regjistruara në AShMA nuk do të kenë të drejtë të paraqiten në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për reklamim të paguar politik.

Drejtori Trajçevski shpjegoi se, pas informacionit të publikuar në lidhje me formimin e grupit të punës dhe zgjedhjes së kryetarit, i dërgoi mesazh Ministrit të Drejtësisë duke pyetur nëse kishte ndonjë qëllim ose plan që në grupin e punës të përfshihen dhe institucione të tjera relevante, siç janë Enti Shtetëror për Revizion, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Ai shtoi se ende nuk ka marrë përgjigje nga ministri.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**